



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 nën d), nenit 40 paragrafi 2 nën c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, nenit 15 dhe 16 nën pikën 7 dhe nenit 18 të Statutit të Komunës, nenit 6 paragrafi 2 i Rregullores Komunale për Ndarjen e subvencioneve dhe transferove, me kërkesën e drejtorisë së Arsimit 01nr.400-785/16 të dt.14.03.2016, rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa të dt.14.03.2016, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të të rregullt, të mbajtur më 25.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

Për

Vënie në diskutim publik të Projekt-rregullores komunale për ndarje të bursave për student të Komunës së Klinës në Universitetet Publike të Republikës së Kosovës

I

Miratohet vendimi për vënie në diskutim publik të Projekt-Rregullores Komunale për ndarje të bursave për student që studiojnë në Universitetin Publik të Republikës së Kosovës.

II

Projekt-Rregullorja si në pikën 1 të këtij Vendimi lëshohet në diskutim publik 15 ditë prej ditës së shpalljes në tabelën e shpalljeve dhe ueb faqen e Komunës.

III

Brenda 15 ditëve të diskutimit publik të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës, personat fizikë dhe juridikë, si dhe të gjithë të interesuarit mund të marrin tekstin e Rregullores në Zyrën ligjore në objektin e Komunës, si dhe vërejtjet dhe sugjerimet me shkrim mund të jepen pranë kësaj zyre.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës, respektivisht 15 ditë pas pranimi të vendimit nga Zyra e protokollit të MAPL.

V

Vendimi është transparent përmes: Tabelës së shpalljeve, Zyrës për Informim.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01 Nr. 06-1242 /2016
Klinë, më 04.04 /2016



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi